



VENDIM

Nr. 36 Datë 15.04.2011

MBI ANKIMIMIN E CEZ SHPËRNDARJE SH.A TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 31, DATË 31.03.2011 PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 01.01.2011 – 31.12.2011

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.04.2011, mbasi shqyrtoi ankimimin e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a në lidhje me kontratën e furnizimit me energji për vitin 2011 ndërmjet KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, dhe relacionin e Drejtorive Teknike

Konstatohet se :

CEZ Shpërndarje sh.a, me anë të këtij ankimimi, ka paraqitur në ERE të njëjtat argumenta që janë diskutuar me palët për këtë çështje gjatë komunikimeve zyrtare ne adrese te njera tjetres si dhe ne ERE, sikurse edhe gjatë mbledhjeve të Bordit të Komisionerëve të datave 4.03.2011, dhe 31.03.2011, në të cilën përfaqësues të CEZ Shpërndarje kanë qenë prezent. Ky ankimim nuk sjell asgjë të re dhe të panjohur nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të mospranojë ankimimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a dhe lënien në fuqi të vendimit nr.31, datë 31.03.2011 “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesi Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011”.



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë ankimuese CEZ Shpërndarje sh.a si dhe KESH sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 36 Datë 15.04.2011

MBI

ANKIMIMIN E CEZ SHPËRNDARJE SH.A TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 31, DATË 31.03.2011 PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË CEZ SHPERNDARJE SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 01.01.2011 – 31.12.2011

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____